

Bjorn Lomborg

KOPENHAGË, 14 TETOR – Një nga problemet më të mëdha me të cilat përballen të varfrit e botës është një problem për të cilin kanë dëgjuar shumë pak njerëz: rrjedhja e paligjshme e parasë. Ndonëse rrjedhjet e tilla dëmtojnë njerëzit në Xhibuti, Kongo dhe Çad për më shumë se një të pestën e të ardhurave të tyre për çdo vit, një gjë e tillë nuk përmendet kurrë. Derisa bota po përgatitet që të vendosë objektiva specifike, të cilat do të shërbejnë si bazë për përpjekjet zhvillimore globale të 15 vjetëve të ardhshëm, koha për ndryshime ka ardhur.

Duke pasur parasysh se objektivat e reja zhvillimore globale – si Qëllimet e Mileniumit për Zhvillim, që janë përqendruar tek shëndetësia, uria dhe arsimimi – mund të ndihmojnë në alokimin e qindra miliardë dollarëve zhvillimorë, përzgjedhja e fushave në të cilat duhet fokusimi është vendimtare. Bashkësia ndërkombëtare, e vërsuar nga qindra objektiva të propozuara, pa dyshim se përballen me një sfidë të madhe.

Për të ndihmuar në udhëzimin e procesit, Qendra e Kopenhagës për Regjistrime u ka kërkuar 62 ekipeve me ekonomistë me nam që të përcaktojnë se ku do të mund të shfrytëzoheshin më së miri burimet e kufizuara.

Disa prej objektivave që ata kanë identifikuar – si rritja e sigurisë për ushqim, rritja e mundësive për arsimim dhe përmirësimet në shëndetësi – nuk ishin befusuese.

Megjithatë, një nga rekomandimet – pengimi i rrjedhjeve të paligjshme financiare – ishte i papritur. Edhe ashtu, në shikim të parë, rrjedhjet e tilla nuk duket të jenë aq të fuqishme apo aq të rrezikshme që të shihen si rrezik për mirëqenien e njerëzve, siç është, për shembull, mungesa e ushqimit. Shumë njerëz bile as që i

Paratë e pista për zhvillim

marrin si problem rrjedhjet e tilla financiare.

Sidoqoftë, ekonomisti Alex Cobham insiston se pengimi i rrjedhjeve të tilla duhet të jetë prioritet. Dhe argumentet e tij janë të fuqishme.

Instituti Gopal për Integritet Financiar (GFI) raporton se në vitin 2011, shtetet në zhvillim humbën gati një miliardë dollarë përmes transferimeve të paligjshme drejt botës së zhvilluar. Në të njëjtën mënyrë, njëzet shtete afrikane kanë humbur shuma të barasvlershme me më shumë se 10 për qind të GDP-së së tyre për çdo vit, që nga 1980-ta. Në njëfarë aspekti, kjo e bën Afrikën kreditore të botës, ndonëse ajo nuk mund të presë që t'i kthehen këto kredi. Rreth 85 miliardë dollarë kanë rrjedhur në mënyrë të paligjshme nga India më 2011.

Ku po shkojnë paratë? Regjimet kleptokratike shpesh transferojnë një pjesë të pasurisë së shteteve të tyre në llogaritë bankare zvicercane. Një gjë e tillë, ashtu si edhe shpëlarja e parasë nga organizatat kriminale, natyrisht se është e paligjshme (ashtu si edhe moralisht e pakuptueshme).

Megjithatë, ekziston edhe mekanizmi ligjor për rrjedhjet e tilla financiare: ikja nga tatimet. Ndonëse nuk është shkelje penale, shmangia nga tatimet tërheq kritika të përhapura – aq më shumë, për shkak se është e zakonshme midis kompanive të mëdha shumëkombëshe, përfshirë “Amazon”, “Starbucks” dhe “Google”. Këto kompani minimizojnë obligimet e tyre tatimore duke regjistruar dhe duke deklaruar profitet e tyre në një shtet me norma të ulëta tatimore, ndonëse biznesin e

zhvillon gjetkë.

Po ashtu një metodë tjetër e zhvendosjes së kapitalit është ndërrimi i shumave nëpër fatura, kur kompanitë ndërrojnë vlerën e importeve dhe eksporteve. Një studim i mëparshëm i GFI-së pati bërë të ditur se nga viti 2002 deri më 2011, 60.8 miliardë dollarë u zhvendosën në mënyrë të paligjshme brenda dhe jashtë Ganës, Kenisë, Mozambikut, Tanzanisë dhe Ugandës.

Marrë në tërësi, rrjedhjet e paligjshme financiare aktualisht përbëjnë gati dhjetëfishin e shumës totale të ndihmave ndërkombëtare. Ta marrim me mend se sa mirë do të mund të shfrytëzoheshin ato para, po të kanalizoheshin drejt projekteve për rritjen e mirëqenies.

Për këtë arsye, Cobham ka propozuar përfshirjen në agjendën e ardhshme zhvillimore të kushtit që të gjitha informatat rreth pronësisë së përfituesve të jenë publike. Duke ua vështirësuar individëve fshehjen prapa kompanive, rregullat e tilla do të vështirësonin rrjedhjet financiare – dhe do të vëreheshin shumë më lehtë.

Po të rezultonin përpjekjet e tilla me një reduktim të vetëm 10 për qind të humbjeve mesatare nga rrjedhjet e paligjshme financiare, krahasuar me 2002-2012, atëherë shtetet do të shpëtonin 768 miliardë dollarë – para që mund të përdoreshin për financimin e projekteve zhvillimore. Ndërkohë reduktimi prej 50 për qind do të shpëtonte një shumë marramendëse prej 7.5 miliardë dollarësh.

Natyrisht se rregullat e propozuara nga Cobham do të bartnin kosto të konsiderueshme administrative.

Por, madje edhe nëse del i vërtetë vlerësimi prej 66 miliardë dollarësh, shtetet e varfra do të fitonin 13 dollarë të ardhura shtesë për një dollar të shpenzuar. Një normë më e mundshme e kthimit do të ishte 49 dollarë për një dollar të shpenzuar.

Ndikimi i rregullave mund të fuqizohet nga dy propozime të tjera: shkëmbimi automatik i informatave tatimore midis juridiksioneve, ashtu si edhe kushti që kompanitë shumëkombëshe të raportojnë të ardhurat mbi bazën shtet-për-shtet. Ky nivel i transparencës – që në disa raste do të nënkuptonte “emërimin dhe turpërimin – mund të transformojë mënyrën se si kompanitë menaxhojnë çështjet e tyre financiare. Ndonëse është jashtëzakonisht vështirë të vlerësohen kostot dhe përfitimet precize, lirisht mund të thuhet se masat e tilla do të ishin efektive në aspektin e kostos.

Por po që se duam të funksionojnë masat e tilla, atëherë ato duhet të zbatohen në mënyrë sa më strikte që të jetë e mundur.

Fatkeqësisht korniza ekzistuese për parandalimin e shpëlarjes së parave nuk paraqet precedencë inkurajuese. Ndonëse ajo kornizë është e pranuar universalisht dhe zbatohet në shumicën e shteteve, shpëlarja e parave mbetet dukuri e pranishme.

Natyrisht se ushqimi, arsimimi, shëndetësia dhe ambienti janë elemente të rëndësishme të agjendës së ardhshme zhvillimore. Por liderët botërorë kanë arsye që rrjedhjet e paligjshme financiare t'i shtojnë në listë.

(Autori, profesor bashkëpunëtor në Shkollën për Biznes të Kopenhagës, është themelues dhe kryetar i Qendrës së Kopenhagës për Regjistrime. Vështrimi është shkruar për rrjetin e gazetarisë botërore, “Project Syndicate”, pjesë e të cilit është edhe “Koha Ditore”)

KOHA DITORE

E përditshme e pavarur informative

Themelues: Veton SURROI
Numri i parë u botua më 31 mars 1997

Pronare dhe botuese:
Flaka SURROI

Gazeta redaktohet nga kolegji:
Kryeredaktor: Agron BAJRAMI
Zv. kryeredaktore: Valbona MEHMETI
Redaktore: Brikenda REXHEPI
Redaktor: Elmaz ISUFI

Zenun ÇELAJ (Portali),
Bekim KUPINA (Kosovë),
Visar LOCI (Sport),
Granit KURTI (Kulturë),
Nita LLESHI & Arbana MJEKIQI (Botë),
Sami KÇIKU (Mes për Mes),
Ben KAJTAZI (Qendra Grafike),
Alban BUJARI & Driton PAÇARADA
(Fotografi)

Telefonat e redaksisë:
038/249-104
249-105; 243 875
Fax: 038/249-106

Fahu postar 202
e-mail: redaksia@kohaditore.com
Marketing: tel & fax: 038/248-880
e-mail: marketing@kohaditore.com
marketing@koha.net